



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 23 / 1 / 2023

VENDIM
Nr. 05, datë 23/01 /2023

PËR

**STANDARTIN TEKNIK SHTETEROR TE PROJEKTIMIT DHE KONTROLLIT TE
DIGAVE REZISTENTE NDAJ TERMETIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 23.01.2023 mori në shqyrtim ceshtjen e standartit teknik shtetëror për projektimin dhe monitorimin e digave të mëdha dhe veprave hidroteknike të tyre rezistente ndaj efekteve të Tërmetit.

Gjatë diskutimeve, antarët e KKDM vlerësuan rëndësinë e Rregullores së inspektimit të digave pas tërmetit të aprovuar me vendimin e KKDM, Nr. 06, datë 16.11.2020 e cila u përdor gjatë inspektimit nga shfrytëzuesit e disa digave të mëdha që ndodheshin brenda zonës prej 25 km ku u ndjenë lekundjet e tërmetit të datës 15 Janar 2023 me magnitudë 4.7 shkallë Richter dhe thellësi 8.8 km.

Antarët e KKDM ngritën shqetësimin e mungesës së standartit teknik shtetëror ndaj efekteve të Tërmetit për projektimin e digave të reja si dhe për monitorimin, sigurinë dhe projektet e rehabilitimit të digave ekzistuese në vendin tonë. Në diskutime u vu theksi tek domosdoshmeria e këtij standarti duke u bazuar në eksperiencat e vendeve europiane, rekomandimet e ICOLD të dhëna në Buletinet përkatëse si dhe standartet teknike bashkëkohore të vendeve që ndodhen në zonat me sizmicitet të lartë në fushën e rezistencës së digave të mëdha ndaj tërmetit. Standardi i ri duhet të synojë zëvendësimin e Kushteve teknike në fuqi të projektimit antisizmik të digave, të cilat nuk janë rishikuar që prej 35 vitesh, me dispozita të reja teknike për t'u zbatuar në fushën e projektimit antisizmik të tyre si dhe të kontrollit të sigurisë ndaj riskut sizmik. Bazuar në situatën aktuale, u ra dakord për domosdoshmërinë e hartimit dhe miratimit zyrtar të Standartit teknik shtetëror në lidhje me normat e kërkuara për rezistencën ndaj tërmetit në projektimin e digave të reja si dhe në monitorimin, sigurinë dhe projektet e rehabilitimit të digave ekzistuese në vendin tonë sipas legjislacionit në fuqi nga institucionet përgjegjëse.

Në mbështetje të Ligjit Nr.8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha,

VENDOSI:

- 1- Ti kërkoj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përgatitjen e **Standartit Teknik Shtetëror për Projektimin dhe Kontrollin e Digave rezistente ndaj Tërmetit** që duhet të përdoret në projektimin e digave të reja si dhe në monitorimin, sigurinë dhe projektet e rehabilitimit të digave të mëdha ekzistuese.
- 2- KKDM të mbështet këtë proces me eksperte të fushës dhe përmes bashkëpunimit me institucione kërkimore-shkencore me eksperiencë në fushën e përgatitjes së standarteve teknike Ky proces dhe Standarti Teknik përkatës do të shqyrtohet dhe miratohet në KKDM si dhe institucionet shtetërore përkatëse sipas legjislacionit në fuqi

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionit në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

